



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



**Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të**  
**Pronës së paluajtshme Komunale**  
**14 Nr. 03/16**  
**Dt. 29.09.2016**

Në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, Nr.105/16 datë 25.05.2016, Nr. 125/14 dt. 28.05.2014 dhe Rekomandimit nr. 323/16 dhe 324/16 dt. 07.07.2016 të Drejtorisë Komunale për Urbanizëm e Mbrojtje të mjedisit, Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, më datë 29.09.2016, shpallë :

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE**

**Numri referues i shitjes: 644 – 16 – 003 – P.K.**

**NENI I: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

**EMRI ZYRTAR DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

Emri i AK	Komuna Vushtri <b>Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale</b>	Personi kontakt:	<b>Hyda Dallku , tel. 044 – 147 - 181</b> <b>Iliriana Azemi, tel. 044 – 347 - 419</b>
Adresa	Rr "Adem Jashari " nr.1	Kodi postar	42000
Qyteti	Vushtri	Regjioni	Mitrovicë
Telefoni		Fax	
e-mail	<a href="mailto:pronatkomunale@hotmail.com">pronatkomunale@hotmail.com</a>		

**NENI II: LËNDA E ANKANDIT**

Autoriteti kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, në bazë të Vendimit nr. 105/16 datë 25.05.2016 të Kuvendit Komunal dhe Rekomandimit nr. 323/16 dhe 324/16 dt. 07.07.2016 të Drejtorisë Komunale për Urbanizëm e Mbrojtje të Mjedisit, ka përcaktuar si qëllim dhënien shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale personave Juridik dhe personave fizik, përmes ankandit publik, **procedura përmes ofertave të mbyllura.**

**Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme komunale, si vijon:**

1. Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr. P-70202016-0000127-0, Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës, e cila përfshinë një sipërfaqe të përgjithshme prej 344m<sup>2</sup>, jepen në shfrytëzim 0.90m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e shtëpisë dhe oborri në sipërfaqe prej 187m<sup>2</sup> ( sipërfaqja e tërësishme e cila jepet në shfrytëzim është 277m<sup>2</sup> ) e cila gjendet në rr. " Dëshmorët e Kombit "
2. Prona Komunale në Sheshin " Hasan Prishtina ", Ngastra Kadastrale nr. P-653-0, Zona Kadastrale Vushtri, Lokali nr. 6 në sipërfaqe prej 13m<sup>2</sup>.
3. Prona Komunale në Sheshin " Hasan Prishtina ", Ngastra Kadastrale nr. P-653-0, Zona Kadastrale Vushtri, Lokali nr. 12 në sipërfaqe prej 13m<sup>2</sup>.
4. Lokacioni i cili gjendet me lokalet në rr. " Jeton Tërstena " ngastra Kadastrale P-2254/49, Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, lokali nr. 3 në sipërfaqe 11m<sup>2</sup>, nr. 5 në sipërfaqe 11m<sup>2</sup> dhe nr. 8 në sipërfaqe 62m<sup>2</sup>.
5. Kriteri i Dhënies së Kontratës : Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lartë.
6. Çmimi fillestarë për Lokacionin sipas pikës 1 të këtij Njoftimi është 800€.

7. Afati i dhënies në shfrytëzim të Lokacionin sipas pikës 1 të këtij Njoftimi është 10 vite.
8. Afati i dhënies në shfrytëzim të Lokacionin sipas pikës 2 dhe 3 të këtij Njoftimi është 5 vite me mundësi vazhdimi edhe për 5 vite.
9. Çmimi fillestarë për Lokacionin sipas pikës 4 të këtij Njoftimi është 2.00€/m<sup>2</sup>.
10. Afati i dhënies në shfrytëzim të Lokacionin sipas pikës 4 të këtij Njoftimi është 5 vite me mundësi vazhdimi edhe për 5 vite.
11. Veprimtaria që ushtrohet në hapësirat e dhëna në shfrytëzim sipas pikës 1, 2 dhe 3 të këtij Njoftimi është kryesisht veprimtari shërbyese, zejtare, artizanati, tregtare etj. Për më tepër informacione referoju Dokumentit të Ankandit, Pjesa XIII. Specifikimi i Çmimeve dhe Veprimtarive.

### **NENI III: INFORMATA ADMINISTRATIVE**

1. Afati kohorë i fundit për tërheqjen e dokumentacionit të ankandit: data **28.10.2016 ora 15.00**
2. Afati i kohorë për dorëzim - pranimin e Aplikacioneve: data **31.10.2016 ora 13.30**. Vendi: Komuna Vushtri, zyra nr. 1 kati i I-ë.
3. Takimi për hapjen e Aplikacioneve bëhet më datë **31.10.2016, ora 14.30**, vendi : Salla e Kuvendit Komunal – Vushtri.
4. Ofertat duhen dorëzuar të mbyllura. Për më tepër informacione, lexo me kujdes pikën VII të Dosjes së Aplikimi.
5. Numrat kontaktues : **044 – 147 – 181** dhe **044 – 347 - 419**
6. E-maili :
7. Informacionet shtesë mundë ti kërkoni përmes përdorimit të formularit bashkangjitur Dosjes së Aplikacionit. Për më tepër informacione shiko pikën VI. të dokumentit të ankandit.
8. Tërheqja e aplikacionit mundë të bëhet në formë fizike dhe elektronike.

### **NENI IV: ANKESAT**

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë te Komisioni për Ankesa pran Komunës së Vushtrrisë, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.